



VENDIM

Nr.96 Date 27.10.2014

**PER LICENSIMIN E SHOQERISE OPERATORI I
SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE SH.A NE
AKTIVITETIN E SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa c, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa c, 13, 14 të “Rregullores për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a për Licënsimin në Aktivitetin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike

Konstatoi:

- Paraqitjen pergjithesisht te dokumentacionit nga Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike sh.a sic kerkohet nga “Rregullorja për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshem dhe rinovimit të licensave”,

Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI :

1. Te licensoj në aktivitetin e shperndarjes te energjise elektrike shoqerine Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike sh.a (OSHEE) per nje afat 30 vjeçar.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
2. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i Komisionerëve sipas nenit 16 te Ligjit. 9072, date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” , i ndryshuar.
 3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje aplikuesin, Ministrine e Energjise dhe Industrise si dhe Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Siper marrjes per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 96 Date 27.10.2014

**PER LICENSIMIN E SHOQERISE OPERATORI I
SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE SH.A NE
AKTIVITETIN E SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Anetaret e Bordit

	Pro	Kundë r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____